



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Delta Security shpk" të datës 01.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Delta Security shpk" të datës 01.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Delta Security shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 01.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Ne me ofertë kemi prezantuar deklaratat e specifikuar në kërkesën e lartcekur dhe kjo gjë nuk është konstatuar fare nga AK-ja. Kur analizohet kërkesa e lartcekur, kuptohet qartë se askund në dosje të tenderit dhe po ashtu edhe tek njoftimi për kontratë nuk është specifikuar ndonjë kriter vlerësimit. Nga ky fakt kuptohet se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm sepse askund nuk është specifikuar që OE duhet të dorëzojnë ndonjë analizë financiare siç e ka cekur AK-ja. Nga përgjigjja e lartcekur e AK-së shihet qartë se vet AK-ja nuk do të jetë kusht për kualifikim dhe përgjigje, mirëpo edhe përkundër kësaj përgjigjeje AK-ja përsëri na ka eliminuar me një arsyetim krejtësisht absurd. Ne e kemi dorëzuar analizën financiare shumë të detajuar dhe nuk kemi lënë pikë pa e sqaruar ku në mënyrë të detajuar janë dhënë shënimet për secilin lloj të orareve të punës. Pra ne edhe sikur AK ta kishte përcaktuar si kriter të vlerësimit analizën financiare për këtë pikë nuk ka mundësi që të eliminohej nga e njëjta, me arsyetimin se analiza nuk përmban një informacion të mjaftueshëm që të justifikoj çmimin e paraqitur".

Parashtruesi po ashtu ka parashtruar pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuar në kërkesën për rishqyrtim.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye për LOT I:

4. "Delta Security" SH.P.K.

Pas shqyrtimit dhe krahasimit të ofertës së Delta Security SH.P.K., komisioni ka konstatuar se analiza financiare e ofruar nuk përmban informacion të mjaftueshëm që të justifikojë çmimin e paraqitur, sipas Aneksit 1 të specifikimit teknik të detyrueshëm, ju ne analizën tuaj nuk keni paraqitur: Pagat Bruto për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet, -a) Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore, b)- Shpenzimet operative, përfshirë vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosje të tenderit dhe shpenzimet tjera, fitimin e paraparë, c)- Çmimi i total i tenderit duhet të llogaritet dhe inkorporohet në çmimin e orëve në tabelën e specifikimit të çmimit. Komisioni, pas shqyrtimit të plotë të ofertës, konstaton se ajo është e papërgjegjshme, pasi nuk ka ofruar dëshmi bindëse mbi arsyetimin e çmimit, si dhe bazuar në vendimin e OSHP: 2025/0471.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Kjo për arsye se në vendimin e OSHP 2025/0471 është konfirmuar se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pikërisht për shkak të analizës financiare. Në anën tjetër nuk është kontestues fakti që analiza financiare ka qenë kërkesë e DT dhe ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi mirëpo i njëjti aludon që analiza nuk mund të përdoret si arsye eliminuese. Në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP çdo kërkesë e DT duhet të përmbushet në tërësi për t'u konsideruar një ofertë si e përgjegjshme.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.